



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA  
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA**

*Ministria E Arsimit, Shkencës, Teknologjisë Dhe Inovacionit /Ministarstvo Za Obrazovanje, Nauku, Tehnologiju I Inovaciju / Ministry Of Education, Science, Technology& Innovation*

**Thirrje publike për shprehje të interesit për të qenë pjesë e komisioneve  
vlerësuese për vlerësimin e Projektpropozimeve të OJQ-ve**

**Prishtinë 23 gusht 2021**

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit gjatë vitit 2021, planifikon që përmes thirrjes publike të ofrojë mbështetje financiare për implementimin e projekteve të organizatave joqeveritare që menaxhojnë me qendra mësimore që ofrojnë mësim plotësues për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në fushat prioritare që ndërlidhen me:

- Projekte për përmirësimin e pjesëmarrjes dhe rezultateve të mësimin në arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm, përmes arsimit plotësues dhe mbështetjes për nxënësit romë, ashkali, egjiptianë dhe të tjerë.

\* Projektet që synojnë aktivitetet mbështetëse arsimore për studentët rom, ashkali, egjiptian dhe të tjerë në arsimin parauniversitar.

- Projektet që synojnë ngritjen e kapaciteteve për stafin e qendrës mësimore për të mbështetur nxënësit rom, ashkali, egjiptian dhe të tjerë.
- Projekte që synojnë rritjen e vetëdijes së prindërve për rëndësinë e edukimit të nxënësve nga komunitetet rom, ashkali, egjiptian dhe komunitetet e tjera.
- Projekte që synojnë përmirësimin e bashkëpunimit midis qendrave mësimore, shkollave dhe Drejtorive Komunale të Arsimit.

Rregullorja MF - nr - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, në nenin 8, paragrafi 3.2 parasheh që pjesë e çdo komisioni vlerësueses për vlerësimin e

projektpropozimeve të OJQ-ve të pranuar sipas thirrjeve publike, duhet të jenë dy përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm, duke përfshirë përfaqësues të OJQ-ve. Për këtë qëllim, MASHTI fton të gjithë kandidatët e interesuar që të aplikojnë për të qenë pjesë e regjistrit të ekspertëve të jashtëm, të cilët sipas nevojës së institucionit do të caktohen në cilësinë e anëtarëve në komisione vlerësuese për të vlerësuar projekt propozimet e dorëzuara nga OJQ-të për financim përmes fondeve publike.

Të drejtë aplikimi kanë:

- Të punësuarit në organizatat joqeveritare aktive në Republikën e Kosovës;
- Ekspertë të pavarur, të cilët kanë të paktën 5 vite përvojë pune që ndërlidhet me administratën publike, hartimin dhe menaxhimin e projekteve apo fusha të ngjashme.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Duhet të kenë të kryer së paku nivelin e studimeve Bachelor;
- Të kenë të paktën 5 vite përvojë pune;
- Të kenë përvojë në projektet e OJQ-ve;
- Të mos jenë të emëruar politikë, shërbyes civil apo pozita të ngjashme në administratën shtetërore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Një letër motivimi;
- Një CV të përditësuar;
- Dëshmi për shkollimin dhe përvojën e punës;
- Të punësuarit në OJQ duhet të dorëzojnë një letër nominimi nga udhëheqësi i OJQ-së në të cilën aplikuesi është i punësuar.

Aplikimi mund të bëhet jo më larg se data 03.09.2021, duke dorëzuar një kopje fizike të dokumentacionit të kërkuar në zyrën nr. 4 Arkiv- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

*MASHTI, do të vlerësoj të gjitha aplikacionet e pranuar dhe kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara përmes kësaj thirrje publike do të bëhen pjesë e regjistrit të ekspertëve të jashtëm të cilët do të ftohen sipas nevojës për të qenë pjesë e komisioneve vlerësuese, sipas thirrjeve publike që do të bëjë MASHTI gjatë vitit 2021.*